

Nxitje artificiale e lindjes dhe transferimi te një spital tjetër

Informacion për gratë/
njerëzit shtatzënë

Albanian

Gjatë kohës që jemi të ngarkuar kujdesi juaj dhe ajo që ka rëndësi për ju është ende shumë e rëndësishme për ne; ne do të diskutojmë gjithçka së bashku dhe ju mund të bëni çdo pyetje.



Vonesa në nxitjen artificiale të lindjes

Ndonjëherë pavijonet e maternitetit janë më të ngarkuar se normalisht, veçanërisht kur shumë foshnja duhet të lindin në të njëjtën kohë. Kur kjo ndodh, mund të jetë e nevojshme të ndryshojmë personelin dhe t'u japim përparësi atyre në urgjencë. Të gjitha nxitjet artificiale janë të rëndësishme, por ndonjëherë mund të jetë e nevojshme që kjo të vonohet ose mund të transferoheni në një spital tjetër i cili mund të ofrojë kujdes më të shpejtë. Kjo ndodh vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

Ky lajm mund t'ju zhgënjë, veçanërisht nëse keni planifikuar vizita të tilla si kujdesi për fëmijët, vizitat e familjes dhe sigurisht, të lindni foshnjën tuaj. Ju gjithashtu mund të shqetësoheni për faktin se sa e sigurt është që ju dhe foshnja juaj të prisni.

- Nëse diçka është shumë e vështirë ose me të vërtetë është e rëndësishme për ju, ju lutemi, flisni me ne; ne mund të mos jemi në gjendje të ndryshojmë diçka, por gjithmonë dëshirojmë të dimë se si ndiheni.
- Vonesat në fillimin ose vijimi i nxitjes artificiale të lindjes do të ndodhë vetëm nëse është e sigurt që kjo të bëhet dhe pasi stafi i spitalit të ketë bërë gjithçka që mundet për të vazhduar siç është planifikuar.

Gjatë vonesës, mamia mund të diskutojë me ju lidhur me lëvizjet e foshnjës suaj dhe për të ditur se si ndiheni. Nëse ndodheni në shtëpi, mund të kërkojmë që të paraqiteni në spital për një kontroll. Kjo mund të përfshijë monitorimin e foshnjës (CTG), skaner ose kontrolle të tjera. Mund të kërkojmë nga ju që të qëndroni në spital, ndërsa prisni për nxitjen artificiale të lindjes, por kjo do të diskutohet me ju.

Nëse jeni në spital ose në shtëpi, nëse jeni të shqetësuar ose keni ndonjë nga këto simptoma, telefononi linjën e vlerësimit të shtatzënisë ose flisni me një mami në spital.

Numri i telefonit që duhet të telefononi është _____



Gjakderdhje vagjinale



Rrjedhje të shtuar,
veçanërisht nëse është
i hollë si ujë



Plasja e ujërave



Lëvizjet e foshnjës
reduktohen ose
ndryshojnë



Ndjesi si e sëmurë ose
keni temperaturë



Dhimbje barku që
shkon dhe vjen ose
mund ta keni gjatë
gjithë kohës



Kruajtje



Ënjtje të duarve,
këmbëve ose fytyrës



Ndryshim në shikim ose
dhimbje koke

**Si gjithmonë, është e rëndësishme të jeni në
dijeni të lëvizjeve të foshnjës suaj dhe të vini
re çdo ndryshim**

Transferimi në një spital tjetër

Ndonjëherë mund të zgjidhni të shkoni në një spital tjetër për të lindur fëmijën tuaj nëse atje ju ofrojnë kujdes më shpejt. Nëse kjo është një mundësi atëherë do ta diskutojmë me ju. Kjo është zgjedhja juaj dhe nuk jeni e detyruar të shkoni në një spital tjetër.

Preferencat tuaja të lindjes dhe ajo që është me rëndësi për ju është me rëndësi edhe për ne. Ju do të keni mundësi të bëni pyetje dhe të diskutohi nëse ndonjë nga këto gjëra mund të ndikojë në preferencat tuaja të lindjes.

Nëse vendosni të shkoni në një spital tjetër, ekipi që kujdeset për ju do të sigurojë që spitali ku shkoni të ketë të gjitha të dhënat e rëndësishme, duke përfshirë preferencat tuaja të lindjes dhe planin e personalizuar të kujdesit (nëse keni përgatitur një të tillë). Pasi lindjes së foshnjës, spitali aktual do të kontaktojë me spitalin tuaj të parë për të hartuar një plan për kujdesin tuaj pas kthimit në shtëpi.



[southeastclinicalnetworks.nhs.uk/
induction-of-labour](https://southeastclinicalnetworks.nhs.uk/induction-of-labour)

